



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 85
Prishtinë, më 8 nëntor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 NËNTOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca, Daut Haradinaj, Ganimete Musliu, Teuta Sahatqija, Liburn Aliu, Muhamet Mustafa, Burim Ramadani, Nijazi Idrizi, Ismet Beqiri dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, në lidhje me atë se kur dhe me kë është takuar në spitalin e Mitrovicës?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtrroi pyetje për kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, në lidhje me atë se a është pajtuar kryeministri i Kosovës kohë më parë në Bruksel që Misioni i EULEX-it të ketë dy mandate në Kosovë, një për pjesën veriore dhe një tjetër për pjesën tjetër të Kosovës?

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Para se të procedohet me pikat e tjera të rendit të ditës, deputeti Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së, propozoi që **Projektligji për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit** të shtyhet për një mbledhje tjetër, me arsyetimin se duhen konsultime shtesë me Komisionin Funkcional, në mënyrë që ky ligj të mos aplikohet për institucionet e Gjyqësorit dhe ato të prokurorive.

Kryetari kërkoi deklarinimin e deputetëve për propozimin e deputetit Armend Zemaj.

Kuvendi me shumicë absolute vendosi që shqyrtimi i dytë i **Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit** të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011,
8. Ratifikimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe të Universitetit të Pejës,
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 1,2 e 5 nëntor 2012.

* * *

Para se të procedohet me pikat e rendit të ditës, kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar Koalicionit Kosova e Re ka propozuar zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Punë të Jashtme.

Ai kërkoi nga deputetët që të deklarohen për propozimin e lartshënuar.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Deputetja Emilija Rexhepi emërohet anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Amir Ahmeti.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për investimet e huaja.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha se ky Projektligj e rregullon mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë, duke u ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garanci fundamentale, të cilat u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë, në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, standardet dhe praktikat e pranura ndërkombëtare.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për investimet e huaja.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për investimet e huaja.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sala Berisha-Shala në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Milivoje Stojanović në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mufera Shinik në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sala Berisha-Shala, Sadri Ferati, Albin Kurti, Hashim Dëshishku, Muhamet Mustafa dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për investimet e huaja.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 37,
Kundër ----- 38,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin për investimet e huaja.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Ministri Hajredin Kuçi tha se ky Projektligj parasheh themelimin, organizimin dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe të avokatëve shtetërorë, mjetet për punë, autorizimet e tyre, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për punën e Avokaturës Shtetërore.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Avokaturën Shtetërore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, Haki Demolli në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Gashi në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzana Novobërdali në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Mufera Shinik në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Avokaturën Shtetërore. Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Ministri Bajram Rexhepi tha se ky Projektligj e rregullon themelimin, organizmin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Në vazhdim, ai tha se Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil është në harmoni me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, me Kushtetutën e Kosovës dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Me pastaj, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Anton Quni në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Xhelili në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Visar Ymeri në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, si Komision Funkcional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari e ftoi Auditorin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditorit që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Raportin e Auditimit për vitin 2011.

Auditor i Përgjithshëm, z. **Lage Olofsson**, tha se shpreh opinionin e përgjithshëm se Pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të financave dhe gjendjes financiare për vitin fiskal 2011.

Ky është një opinion i pakualifikuar i Auditimit, në pajtim me SNISA 400.

Pavarësisht këtij opinionit, mbetet hapësirë për përmirësimin e procesit të konsolidimit, i cili momentalisht është i dobësuar nga:

- Lejimi i korigjimeve të PVF-ve individuale të OB-ve pas datës së konsolidimit pa u reflektuar në PVF-të e BK-së,
- Moslargimi i transaksioneve ndërmjet OB-ve të ndryshme, dhe

- Mosshpalosja e donacioneve të proceduara jashtë sistemit të Thesarit.

Opinionet e dhëna tregojnë se, krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e informacionit po bëhet çdo herë e më e mirë. Në përgjithësi, auditimet tona i kanë nxjerrë në pah edhe zhvillimet pozitive edhe sfidat të cilat duhet të adresohen për të siguruar ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin në sektorin publik.

Qeveria ka treguar progres në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të financave publike. Zbatimi i kornizës ligjore ende lë hapësirë për përmirësim, si dhe është e rëndësishme të forcohet mjedisi i kontrollit. Kjo është një qasje në shpenzimet publike që siguron se paratë e taksapaguesve përdoren në mënyrë ekonomike dhe me kujdes.

Autoritetet qendrore kanë treguar progres në fushën e raportimit. Sfidat më të mëdha në zbatimin e buxhetit kanë të bëjnë me mungesën e kontrollit menaxherial. Ekziston një domosdoshmëri shumë e madhe që të hartohen udhëzues të brendshëm, që do t'i specifikonin rregullat e përgjithshme, udhëzime administrative për situatat dhe nevojat specifike në çdo fushë të politikave. Zbrazëtirat ndërmjet kërkesave dhe praktikës në prokurim dhe certifikim duhet të mbyllen sa më shpejt.

Institucionet e pavarura kanë arritur të fusin në përdorim sisteme adekuate të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Megjithatë, këto sisteme nuk funksiononin plotësisht në praktikë. Disa nga masat e ndërmarra përfshinin hartimin e procedurave, politikave, dhe udhëzuesve të brendshëm, si dhe planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve tona.

Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë një qasje më proaktive në sigurimin e zgjidhjeve transparente dhe të qëndrueshme për këto institucione, duke marrë parasysh nevojën për pavarësi.

Komunat, shumë nga rekomandimet e dhëna më herët, nuk i kanë adresuar ashtu siç duhet. Dobësitë e njëjta janë përsëritur nga viti në vit, duke rezultuar me progres shumë të ngadalshëm në zhvillimin e menaxhimit të financave publike dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e dobët e projekteve, avancat e paguara përpara përfundimit të punëve, niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit, pagesa të shumta të bëra në tremujorin e fundit dhe trajtimi i dobët i të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme janë disa nga sfidat më të shpeshta.

Në *ndërmarrjet publike dhe shoqërore*, Qeveria në shumë raste nuk ka arritur të përzgjedhë borde të drejtorëve të afta që të siguronin në praktikë efikasitet në menaxhimin e kompanive drejt rezultateve pozitive operative dhe financiare.

Procesi i Privatizimit apo shitja e NSH-ve përkatëse nëpërmjet privatizimit dhe likuidimit i ishte afruar nivelit të planifikuar. Në këtë proces janë vërejtur disa dobësi në procedura dhe shmangie nga politikat dhe rregullat. Jo gjithmonë ishin siguruar procedura transparente në privatizim.

Në këtë raport janë dhënë një numër rekomandimesh, të cilat i adresojnë në mënyrë sistematike shkaqet e këtyre sfidave. Rekomandimet i janë dhënë Kuvendit, Qeverisë dhe kuvendeve komunale. Me adresimin e këtyre rekomandimeve, secili shpenzues buxhetor do të jetë në një pozitë më të mirë për ta kryer veprimtarinë publike në një mënyrë më ekonomike, efikase dhe efektive dhe për ta siguruar interesin e taksapaguesve.

Fjalimi i plotë i Auditorit të Përgjithshëm, z. Lage Olofson (në gjuhën angleze) është dhënë në transkript.

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e paraqiti dhe e arsyetoi Raportin me rekomandimet e Komisionit.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me Raportin e Auditorit të përgjithshëm për vitin 2011.

Për këtë pikë diskutuan edhe deputetët: Ramiz Lladrovci në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ali Sadriu në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Hoti në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Albert Kinolli në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sali Morina, Alma Lama, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Ganimete Musliu, Armend Zemaj dhe Afrim Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2011, sipas rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

9. Ratifikimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe të Universitetit të Pejës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend për ratifikim Vendimin për themelimin e Universitetit Publik në Prizren “Ukshin Hoti”, si dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e ka proceduar në Kuvend Vendimin për themelimin e Universitetit Publik “Haxhi Zeka”, në Pejë.

Ai tha se Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media i ka shqyrtuar vendimet e lartshënuara dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës i paraqiti dhe arsyetoi dy vendimet për themelimin e Universitetit Publik në Prizren dhe të Universitetit Publik në Pejë.

Për këtë pikë diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Eqrem Kryeziu në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Shaip Muja, Sabri Hamiti, Ahmet Isufi, Halit Krasniqi, Ismet Beqiri, Emilija Rexhepi, Sadri Ferati, Behar Selimi, Lirije Kajtazi, Nijazi Idrizi, Lutfi Haziri dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e ratifikimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe të Universitetit të Pejës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Ratifikohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, si institucion publik i arsimit të lartë.

Ratifikohet vendimi i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik “Haxhi Zeka” në Pejë.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Kryesuesi tha se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë, foli në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si propozues i çështjes.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, si dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Gashi në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, si dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:

1. Dr.sc. Fejzullah Hasani, kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën E Drejta Penale, (materiale dhe procedurale), zëvendësanëtar i Komisionit Dr. sc. Bajram Ukaj,
2. Adem Vokshi, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndët: E Drejta Civile (materiale dhe procedurale), Familjare, Trashëgimore dhe e Drejta Detyrimore, zëvendësanëtar i Komisionit Dr. sc Haxhi Gashi,
3. Suzana Sejdiu, anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën: E Drejta Tregtare (Ekonomike), zëvendësanëtar i Komisionit Dr. sc. Korab Sejdiu,
4. Prof. dr. Ivan Çukaloviq, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën: Parimet, struktura kushtetuese dhe organizimi i Gjyqësorit, zëvendësanëtar Dr. sc. Visar Morina,
5. Meleqe Behxheti, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës: E drejta e Punës, zëvendësanëtar Mr. sc. Rafet Haxha,
6. Prof. dr. sc. Mirlinda Batalli, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës: E drejta Administrative, zëvendësanëtar Nebojsa Boriq, q,
7. Prof. dr. Asllan Bilalli, anëtar i Komisionit, pyetës i lëndëve: E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zëvendësanëtar Dr. sc. Qerim Qerimi,
8. Elbasan Dervishi, sekretar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

II. Mandati i të emëruarve në pikën I të këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Kryesuesi tha se Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 11 dhe 12.3, të Ligjit nr.04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, i ka shqyrtuar propozimet lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Halit Krasniqi në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri në emër të Grupit Parlamentar të

Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas emërohen:

1. Alban Sutaj - Ministria e Drejtësisë,
2. Fadil Rracaj - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
3. Nenad Stojçetoviq - Ministria për Komunitete dhe Kthim,
4. Bahrije Berisha - Ministria e Financave,
5. Armend Krasniqi - Oda e Avokatëve të Kosovës,
6. Afrim Shala - Gjykata Supreme e Kosovës,
7. Shukrije Gashi - OJQ “Partners Kosova”.

II. Mandati i të emëruarve në pikën I të këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 17:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale